



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0872
Data e Vendimit: 03.10.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Ambienti" SH.P.K.. kundër njoftimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës" me numër prokurimi 623-25-6580-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Rahovecit, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 01.10.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtëafatshme ankesa e OE "Ambienti" SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0872, e datës 08.09.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës" me numër prokurimi 623-25-6580-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Rahovecit që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 08.09.2025, ka pranuar ankesën e OE "Ambienti" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës" me numër prokurimi 623-25-6580-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit, në cilësi të AK-së.

Me 24.07.2025, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërkaq me datën 26.08.2025 është publikuar formulari standard për korrigjimin e gabimeve ku hapja e parë e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 08.09.2025.

OE "Ambienti" SH.P.K me datën 02.09.2025 ora 23:21 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndërkaq me datën 03.09.2025 AK ka refuzuar kërkesën e OE.

Operatori Ekonomik "Ambienti" SH.P.K me datën 08.09.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokoll 872/2025.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 08.09.2025 është planifikuar hapja e ofertave ndërsa OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar me datën 02.09.2025 ora 23:21.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues është jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 paragrafi 1 pika a) të Rregullores për Prokurimin Publik pasi që kërkesa është parashtruar me 02.09.2025 ora 23:21, është në kundërshtim me nenin 108/A pika 3.1.

-Përfundim-

Autoriteti kontraktues – Komuna e Rahovecit, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve të Komunës” me numër prokurimi 623-25-6580-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - " AMBIENTI " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: